



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RAPORT

MBI

MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE,
PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2025,
PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT

MAJ 2025

1

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje.....	
2.	Raporti i shpenzimeve faktike për vitin 2025	
2.1	Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.....	
	Analiza financiare analitike.....	
2.1.1	Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600).....	
2.1.2	Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601).....	
2.1.3	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602).....	
2.1.4	Shpenzimet kapitale (231).....	

1 HYRJE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kolegji si organi i vetëm gjyqësor, gjatë mandatit të tij 9-vjeçar, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për çështjet e rivlerësimit, si dhe juridiksion disiplinor, në përputhje me përcaktimet e nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si Kolegj i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë.

Misioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është: *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*. Kolegji i Posaçëm i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor, me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”.

Përshkrimi i programit: *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”*.

Qëllimi i politikës së programit: *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*.

Objektivi 1 - *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”*.

Treguesi i performancës, i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektiv, është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuara”*.

Për përmbushjen e misionit të tij për vitin 2025, Kolegji ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 115, datë 03.12.2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument përfaqëson Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar, që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apelimit (Kolegji), duke ofruar informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit për periudhën 1 janar deri më 30 prill 2025. Monitorimi i zbatimit të buxhetit për këtë periudhë përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Me qëllim për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur në udhëzimet standarde të hartimit të

buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu edhe në monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2025

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ku në total rezulton të jetë miratuar si plan fillestar një vlerë prej 288 milionë lekë. Këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 01, datë 13.01.2025, për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2025. Në kërkesat buxhetore për vitin 2025, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përcaktuar si produkt kryesor për realizimin e objektivit: “Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”. Aktualisht, deri më 30.04.2025 janë realizuar 34 çështje. Deri në fund të muajit prill 2025, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë:

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

Në mijë lekë

Art.	Emërtimi	Fakt 2024	Buxhet vjetor fillestar 2025 sipas ligjit nr. 115/2024	Buxhet vjetor i rishikuar 2025	Buxheti 4-mujor 2025	Fakt 4-mujori i parë i vitit 2025	Në % mbi buxhetin vjetor	Në % mbi buxhetin 4-mujor
600	Paga	255,274	231,939	231,939	74,500	66,852	29%	90%
601	Sigurime Shoqërore	20,533	30,421	30,421	7,200	6,900	23%	96%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	19,030	23,640	22,640	9,040	2,937	13%	33%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	1009	0	1,000	333	259	26%	78%
230/ 231	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	1289	2,000	2,000	0	0	0%	0%
	Total	297,135	288,000	288,000	91,073	76,948	27%	85%

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA KUNDREJT REALIZIMIT

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit vjetor të Kolegjit, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga të personelit”, me rreth 80%, llogaria “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, me rreth 11%, më pas llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera”, me rreth 8%, ndërkohë që llogaria “Shpenzime kapitale” zë një peshë më të vogël, më pak se 1%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës së Kolegjit. Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për periudhën e 4-mujorit të parë të vitin 2025.

Gjatë 4-mujorit të parë të vitin 2025 është synuar përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në vijim synohet konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit, me qëllim realizimin e treguesve të performancës, të përcaktuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027.

2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Buxheti i miratuar sipas ligjit nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, është 288 milionë lekë dhe gjatë 4-mujorit të parë nuk ka pasur ndryshime në buxhetin e miratuar, por vetëm rialokim të fondit prej 1,000,000 lekë nga artikulli 602 – “Shpenzime operative”, tek artikulli 606 – “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, si më poshtë:

- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 3280/1, datë 21.02.2025, protokolluar në Kolegj me nr. 260/1 prot., datë 24.02.2025.

Rishikimi i fondeve buxhetore

Në mijë lekë

<i>Llog. ekonomike</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani fillestar (ligji nr. 115/2024)</i>	<i>Rialokim për shpenzimet celulare</i>	<i>Plan i rishikuar</i>
600	Paga	231,939	0	231,939
601	Sigurime Shoqërore	30,421	0	30,421
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	23,640	-1,000	22,640

606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	0	1,000	1,250
231	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	2,000	0	2,000
Total		288,000	0	288,000

ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, kanë qenë në vlerën 232 milionë lekë, ndërkohë që plani për 4-mujorin e parë është 74.5 milionë lekë dhe nuk ka pasur rishikim të planit buxhetor për periudhën janar – prill 2025. Brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në masën 90% të planit 4-mujor. Ky buxhet është përdorur gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2025 për mbulimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për Gjyqtarët, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, si dhe punonjësit administrativë të Kolegjit.

Numri i punonjësve në organikë, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, të ndryshuar, është 67 punonjës, ndërkohë që numri mesatar faktik i punonjësve për 4-mujorin e parë të vitit 2025, është 66 punonjës.

Me VKM-në nr. 19, datë 09.01.2025, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”, u miratua një numër shtesë prej 4 punonjësish me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme pune (6 orë/ditë).

2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, janë në vlerën 30.4 milionë lekë dhe për periudhën janar – prill 2025 janë në vlerën 7.2 milionë lekë, dhe nuk ka pasur rishikim të planit buxhetor për periudhën janar – prill 2025. Ky buxhet është realizuar në vlerën 6.9 milionë lekë ose 23% e planit të vitit 2025, ndërkohë që brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në masën 96% të planit 4-mujor. Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe, si rrjedhojë, argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejnë edhe për këtë zë buxhetor.

2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për materiale dhe shërbime të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë operacionale. Shpenzimet për këtë zë zënë 8% të shpenzimeve totale vjetore. Fondet e miratuara në fillim të

periudhës për këtë zë, me ligjin nr. 15/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, kanë qenë në vlerën e 23.6 milionë lekë dhe për 4-mujorin e parë, 9 milionë lekë. Rishikimet e buxhetit në këtë zë konsistojnë në:

- Transferimin e një fondi në vlerë 1 milion lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, për mbulimin e shpenzimeve telefonike, për kontratat individuale të Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020, dhe në Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për vitin 2025, është realizuar në vlerën 2.9 milionë lekë nga 22.6 milionë lekë të planifikuara, ose në masën 13% të planit vjetor, ndërkohë që brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në masën 33% të planit 4-mujor.

Realizimi në këtë masë e buxhetit në shpenzime operative vjen si rezultat i dy arsyeve kryesore:

- a) Vendosje nga Dega e Thesarit e sekuestros konservative dhe bllokimi në këtë mënyrë i fondeve buxhetore të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vlerën 3.7 milionë lekë, në funksion të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të kundërshtuar nga Kolegji, nëpërmjet ankimit të veçantë me nr. 313/8 prot., datë 26.08.2024. Ky ankim nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Nëpërmjet komunikimeve me Degën e Thesarit, Kolegji e ka shprehur në vijimësi vullnetin që, menjëherë pas shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe vendimmarrjes së gjykatës, do të vijojë me ekzekutimin e këtij vendimi dhe, në këtë kuadër, në kushtet kur ankimi i veçantë është mjeti i vetëm ligjor i parashikuar nga ligji për mbrojtjen ndaj vendimit gjyqësor të shkallës së parë, për ekzekutimin e përkohshëm, si dhe në kushtet e tejkalimit të çdo afati ligjor për shqyrtimin e kësaj çështjeje, bazuar në nenet 460, pika 3, 470, pika 3 dhe 471/a të Kodit të Procedurës Civile, për shkaqe tërësisht të motivuara dhe të ligjshme, i ka kërkuar, në mënyrë të përsëritur, Gjykatës përshpejtimin e gjykimit të kësaj çështjeje.
- b) Vijimi i procedurave të prokurimit, gjatë 4-mujorit të parë, por edhe në muajt në vazhdim, lidhur me disa zëra të shpenzimeve, si: shërbime printimi, sigurimi i shëndetit dhe jetës etj.

Nga analizat e kryera nga Kolegji, fondi i miratuar me ligjin vjetor të buxhetit do të realizohet në masën 100%.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

<i>N/artik.</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor 2025</i>	<i>Fakt progresiv 4-mujor</i>
602	<i>Mallra dhe shërbime të tjera</i>	22,640,000	2,937,311
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1,060,000	377,450
2	Materiale dhe shërbime speciale	1,435,000	48,852

7

3	Shërbime nga të tretë	5,450,000	1,419,937
4	Shpenzime transporti	550,000	200,400
5	Shpenzime udhëtimi	250,000	144,387
6	Mirëmbajtje të zakonshme	790,000	12,000
7	Shpenzime për qiramarrje	1,430,000	476,000
8	Shpenzime të tjera operative	12,675,000	258,285

Gjatë periudhës 4-mujore janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet bazuar në kontratat dhe faturat, sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike, ujë, shërbime postare, si dhe taksa blerje karburanti, shlyerja e detyrimeve kontraktuale, prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

2.1.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale për: kancelari, materiale higjieno-sanitare, materiale elektrike dhe artikuj si këto. Plani vjetor i buxhetit i miratuar për këtë zë, është 1,1 milionë lekë, nga i cili është përdorur një fond prej rreth 377 mijë lekë, për të likuiduar faturat për shpenzimet materiale, si: kancelari, materiale higjieno-sanitare etj., të kryera gjatë kësaj periudhe.

2.1.3.2 Materiale dhe shërbime speciale

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me abonimet në shtypin e shkruar, regjistra specifike të protokollit, kodekse, uniforma për seancat gjyqësore, dezinfektim ambientesh, pagesë tarife për OBP etj. Nga 1,4 milionë lekë të planifikuara për vitin 2025, janë përdorur rreth 48,8 mijë lekë ose 3,4%.

Në këtë zë, peshë të madhe zënë nevojat për kuti dhe dosje, për vendosjen e dokumentacionit të institucionit, të klasifikuar me afat ruajtje të përhershme, pas përpunimit të tyre. Bazuar në VKM-në nr. 360, datë 26.04.2017, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, ndryshuar me VKM-në nr. 608, datë 22.09.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka finalizuar procedurën e prokurimit për blerje kutish dhe dosjesh arkivore, nga ana e Kolegjit, në periudhën në vijim do të analizohet nevoja reale për sasinë e kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme.

2.1.3.3 Shërbime nga të tretë

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet utilitare, si: energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri “energji elektrike”, me 45% të totalit të tij. Nga 4.450 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar rreth 1,420 milionë lekë ose 32%. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen edhe shpenzimet për shërbimin e printimit, sipas kontratës me nr. 646/8 prot., datë 05.08.2024. Realizimi i këtij zëri për 4-mujorin e parë është 263 mijë lekë. Gjatë muajit maj ka nisur procedura për prokurimin e këtij shërbimi për periudhën pas muajit qershor 2025, kohë kur planifikohet të përfundojë shërbimi aktual i kontraktuar.

2.1.3.4 Shpenzime transporti

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesët e këmbimit të makinave, goma, bateri, karburant, vend parkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri “karburant”, me 45.5% të totalit të tij, prokurim i cili do të kryhet në muajt në vijim, si dhe “parkim për automjetin e institucionit”, në vlerën 36%, i realizuar tashmë me lidhjen e kontratës me Bashkinë Tiranë. Fondi për këta zëra për periudhën 4-mujore është përdorur në varësi të nevojave për mbajtjen në gjendje të mirë pune dhe sigurimin e vendit të parkimit të automjetit. Planifikimi vjetor ka qenë 550 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është në vlerën 200.4 mijë lekë ose 36%.

2.1.3.5 Shpenzime udhëtimi

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Planifikimi vjetor për këtë zë është 250 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është 144.4 mijë lekë, dhe është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit të drejtuesit të institucionit.

2.1.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme

Në këtë nënartikull janë planifikuar shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve/pajisjeve TIK, të sistemit elektrik, programit financiar “Financa 5”, si dhe mirëmbajtje të mjeteve të transportit. Buxheti vjetor i planifikuar në këtë zë është 790 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është 12 mijë lekë, kjo për faktin se kryerja e procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK është kryer në muajin prill 2025 dhe realizimi i fondeve për këtë zë shërbimi i përket periudhës së mëvonshme.

2.1.3.7 Shpenzime për qiramarrje

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qiranë e ambienteve shtesë sipas kontratës nr. 997/3 prot., datë 26.09.2024. Plani vjetor për këtë zë shpenzimi ka qenë në vlerën 1.4 milionë lekë dhe realizimi 4-mujor është 476 mijë lekë.

2.1.3.8 Shpenzime të tjera operative

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, shpenzime për taksa të ndryshme, licenca *Firewall*, *Microsoft Office* dhe *Zoom Meeting* etj. Procedurat për “Blerje licencash *Firewall/Microsoft Office* dhe *Zoom Meeting*” dhe “Mirëmbajtje *website kpa.al*” janë planifikuar për t’u kryer në periudhën gusht – tetor, sipas planit të prokurimeve për vitin 2025. Procedurat e prokurimit me objekt “Sigurimi i shëndetit për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”, si dhe “Sigurimi i jetës për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive”, janë realizuar në vlerën 119 mijë lekë dhe i përket dy minikontratave të vitit 2025, pas plotësimit të vendeve vakante në muajin janar 2025.

Ka filluar puna për procedurën e prokurimit me objekt: “Sigurimi i shëndetit për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”, për periudhën e ngelur deri në përfundim të mandatit kushtetues të Kolegjit.

2.1.3.9 Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria ekonomike 606)

Buxheti vjetor i detajuar në këtë zë është në vlerën 1 milion lekë dhe realizimi 4-mujor në vlerën 259 mijë lekë ose 26%. Në këtë grup përfshihet fondi për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për Gjyqtarët, Këshilltarët e Kolegjit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe dy Drejtorë Drejtorie, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 3280/1 prot., datë 21.02.2025, nga artikulli 602, "Mallra dhe shërbime të tjera", në artikullin 606, "Transferta për buxhetet familjare dhe individët".

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve, sipas përcaktimit në VKM-në nr. 673, datë 02.09.2020, "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 258 mijë lekë.

2.1.4 Shpenzimet kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2025 në investime është 2 milionë lekë dhe përbën rreth 1% të buxhetit total vjetor të miratuar. Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave të institucionit për pajisje kompjuterike, në vlerën 1 milion lekë dhe pajisje e mobilie zyre, në vlerën 1 milion lekë. Sa i takon realizimit të zërave në investime, ato do të prokurohen në pjesën e dytë të vitit, pas zhvillimit të procedurave me objekt "Blerje pajisje elektronike" dhe "Blerje pajisje e mobilie të ndryshme".

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, për periudhën janar – prill të vitit 2025.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,

Nëpunës Zbatues

Valbona Leka

Nëpunës Autorizues

Alketa Çeli




ANEKSI nr.1 Raporti Përmblidhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Perioda e Raportimit 4 muajtori 1-2025

Emri i Grupit		Kodi i grupit										63		në/lekë	
Vepërmataria e Mblidhjes dhe Rivlerësimi në sistemin e Drejtësisë		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										63		në/lekë	
EMËRTIME		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Kodi i Programit		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Shpenzimet sipas programeve buxhetore		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Emërtimi		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Vepërmataria e apelimit të rivlerësimit kalimtar		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01.02.03.04.05.08.22)		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Emërtimi		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Artikulli		Perioda raportuese										63		në/lekë	
600		Perioda raportuese										63		në/lekë	
601		Perioda raportuese										63		në/lekë	
602		Perioda raportuese										63		në/lekë	
603		Perioda raportuese										63		në/lekë	
604		Perioda raportuese										63		në/lekë	
605		Perioda raportuese										63		në/lekë	
606		Perioda raportuese										63		në/lekë	
230		Perioda raportuese										63		në/lekë	
231		Perioda raportuese										63		në/lekë	
230		Perioda raportuese										63		në/lekë	
231		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz nga të ardh.jashtë limiti		Perioda raportuese										63		në/lekë	
Numri i punonjësve		Perioda raportuese										63		në/lekë	

Nëpunës zbatues	Emri	Valbona Leka	Nëpunës Autorizues	Emri
	Firma			Firma
	Data	27.05.2025		Data




ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periodha e Raportimit 4 mujori I-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periodha raportuese Periodike /Vjetore	Buxheti	Artikujt buxhetore										Total
					230	231	600	601	602	603	604	605	606		
					Shpenzime Kapitule të Përbërëzuar	Shpenzime Kapitule të Grupëzuar	Pagat	Kontribe e Sigurimeve Shqiptare	Molla dhe Shërbime	Subveçnet	Të Tjera Transfer Korrente të Brendshme	Transfer Korrente të Huaja	Transferat për Buxhetet Familjare dhe Individuel	Total	
63	01	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Plani fillestar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	0	288,000,000	
63	01	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Plani i rishikuar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	22,640,000	0	0	0	1,000,000	288,000,000	
63	01	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Fakti	0	0	66,852,162	6,900,032	2,937,311	0	0	0	258,682	76,948,187	
63	01	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
		Total	2025	Plani fillestar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	0	288,000,000	
		Total	2025	Plani i rishikuar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	22,640,000	0	0	0	1,000,000	288,000,000	
		Total	2025	Fakti	0	0	66,852,162	6,900,032	2,937,311	0	0	0	258,682	76,948,187	
		Total	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
		Ndrryshimi ne vlere absolute	2025		0	2,000,000	165,086,838	23,520,968	19,702,689	0	0	0	741,318	211,051,813	
		Realizimi ne %	2025		0	0%	29%	23%	13%	0	0	0	26%	27%	
06		Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Fakti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
06		Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	

Nëpunës zbatues	Emri	Valbona Leka
	Firma	
	Data	27.05.2025

Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	27.05.2025




Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit: 4 majori 1-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 603	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
63	03340	Veprimtaria e apalimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Plani fillestar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	0	288,000,000
63	03340	Veprimtaria e apalimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Plani i rishikuar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	1,000,000	288,000,000
63	03340	Veprimtaria e apalimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Shpenzime faktike	0	0	66,852,162	6,900,032	2,937,311	0	0	0	258,682	76,948,187
63	03340	Veprimtaria e apalimit të rivlerësimit kalimtar	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Ndryshimi në vlerë absolute	2025		0	2,000,000	165,086,838	23,520,968	19,702,689	0	0	0	741,318	211,051,813
		Realizimi në %	2025		0	0%	29%	23%	13%	0	0	0	0	27%
		Total i Ministrise/Institucionit	2025	Plani fillestar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	0	288,000,000
		Total i Ministrise/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	0	2,000,000	231,939,000	30,421,000	23,640,000	0	0	0	1,000,000	288,000,000
		Total i Ministrise/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	0	0	66,852,162	6,900,032	2,937,311	0	0	0	258,682	76,948,187
		Total i Ministrise/Institucionit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Numri i punonjese në Total	2025	Plani fillestar	0	0	67	0	0	0	0	0	0	67
		Numri i punonjese në Total	2025	Plani i rishikuar	0	0	67	0	0	0	0	0	0	67
		Numri i punonjese në Total	2025	Numri faktik	0	0	66	0	0	0	0	0	0	66

Nëpunës zbatues	Emri	Valbona Leka
	Firma	
	Data	27.05.2025

Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Qelje
	Firma	
	Data	27.05.2025



Emri i Grupit		Kodi i grupit											
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë		Kodi i programit											
